



HISTORI KOMPETENCA ORGANIZIM



GJYKATA KUSHTETUESE

**NJË HISTORI
INSTITUCIONALE**

Ky publikim u mbështet nga Këshilli i Evropës në kuadër të projektit “Rritja e kapaciteteve të gjyqësorit për zbatimin më të mirë të standardeve të së drejtës për liri dhe siguri në Shqipëri”, financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF), i cili bashkon tetë shtete anëtare të Këshillit të Evropës: Finlandën, Gjermaninë, Irlandën, Luksemburgun, Holandën, Norvegjinë, Zvicrën dhe Mbretërinë e Bashkuar. Mendimet e shprehura në këtë dokument janë përgjegjësi e autorit/ve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës dhe Fondit të Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF)



PËRMBAJTJA

VIZIONI DHE MISIONI	6
HISTORIKU	7
PËRBËRJA E TRUPAVE GJYQËSORE NDËR VITE	9
PËRBËRJA E GJYKATËS	11
ANËTARËSIA AKTUALE	12
JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT	13
SUBJEKTET QË VËNË NË LËVIZJE GJYKATËN	14
PROCESI KUSHTETUES	16
NJË GJYKATË PËR TË GJITHË QYTETARËT: ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL	18
VENDIMET E GJYKATËS	19
ADMINISTRATA	28
BASHKËPUNIMI DHE PERSPEKTIVA NDËRKOMBËTARE	29
ANËTARËSIA NË FORUME DHE ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË	30
DATA TË RËNDËSISHME PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR	31
KONTRIBUTI NË KULTURËN KUSHTETUESE	32
SIMBOLIKA	36
SHËRBIMET NDAJ PUBLIKUT	38

VIZIONI DHE MISIONI

Gjykata përfaqëson institucionin më të lartë të kontrollit të kushtetutshmërisë në vend, duke shërbyer si garant i rendit kushtetues e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut. Ajo luan një rol kyç si arbitër i balancës ndërmjet pushteteve në vend, ndërsa në planin ndërkombëtar kontribuon në dialogun kushtetues dhe harmonizimin e standardeve demokratike.

Vizioni

Gjykata Kushtetuese jep drejtësi kushtetuese, me integritet dhe besueshmëri të lartë nga publiku, duke garantuar respektimin dhe mbrojtjen e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive të tij, si dhe shtetit të së drejtës.

Misioni

Misioni i Gjykatës Kushtetuese është të garantojë epërsinë e Kushtetutës dhe forcimin e demokracisë në vend nëpërmjet zgjidhjes së mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe interpretimit përfundimtar të Kushtetutës.

HISTORIKU

Historiku i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është i lidhur ngushtë me zhvillimet politike dhe juridike të shtetit shqiptar pas rënies së sistemit komunist në vitet '90. Ato shënuan kthesë rrënjësore në historinë e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të tij. Orientimi demokratik i shtetit kërkonte në atë periudhë kryerjen e një reforme institucionale të thellë, e cila duhet t'i hapte rrugë shndërrimeve demokratike për ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Parimet themelore që udhëhoqën këto ndryshime u shpallën fillimisht me ligjin nr.7491, datë 29.04.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese", më pas me ligjin nr.7561, datë 29.04.1992, "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991, "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Në këtë kuadër, në vitin 1992 u themelua edhe Gjykata Kushtetuese, si një nga institucionet më të rëndësishme për garantimin e rendit të ri kushtetues që po vendosej në Shqipëri. Që në fillimet e veta, ky institucion u konsiderua nga ligjvënësi si autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Sipas ligjit të kohës, Gjykata përbëhej nga 9 anëtarë, 5 prej të cilëve zgjidheshin nga Kuvendi dhe 4 nga Presidenti i Republikës. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhej me votim të fshehtë nga vetë gjyqtarët.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në nëntor të vitit 1998, Gjykata Kushtetuese ruajti një pozitë të rëndësishme në arkitekturën institucionale vendase. Kushtetuta e re parashikoi se, gjyqtarët kushtetues emëroheshin nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Kryetari emërohej nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë riemërimi. Në përputhje me dispozitat kushtetuese, Kuvendi miratoi ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili u hartua me ndihmën e Komisionit të Venecias "Demokracia përmes ligjit". Ky ligj rregullonte çështje të tilla, si mënyrën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin paraprak, procedurat e gjykimit, statusin dhe mandatin e gjyqtarit.

Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 dhe reforma në drejtësi ridimensionuan aspekte të organizimit, funksionimit dhe kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, të cilat u reflektuan si në dispozitat kushtetuese, ashtu edhe në ligjin organik të saj. Konkretisht, u ndryshua formula e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese si dhe u shtuan disa kompetenca në funksion të efikasitetit dhe eficiencës. Gjithashtu, u pasqyruan edhe disa zgjidhje për probleme të hasura gjatë vendimmarrjes së kësaj Gjykate në vite. Një nga aspektet e rëndësishme të kompetencave të ridimensionuara të Gjykatës ishte edhe zgjerimi i ankimit individual, i cili tashmë ka si qëllim një mbrojtje më të madhe të individit ndaj akteve të pushtetit publik.

Në këto më shumë se tri dekada të krijimit të saj, Gjykata Kushtetuese është konfiguruar si institucion kushtetues i mirëfilltë duke u rreshtuar krah simotrave të saj evropiane. Ka marrëdhënie dhe shkëmbime të rregullta me institucione të ngjashme në Evropë dhe ka aderuar në organizma e konferenca të ndryshme, ku jep në mënyrë të vazhdueshme kontributin e saj në shërbim të drejtësisë kushtetuese.



1991-1992

Hidhen bazat kushtetuese të rendit të ri demokratik me miratimin e dispozitave kryesore kushtetuese me ligjin nr. 7491, datë 29.04.1991, si dhe ndryshimet e plotësimet ndaj tij me ligjin nr.7561, datë 29.04.1992.

19 maj 1992



Gjykata Kushtetuese fillon veprimtarinë e saj si organi më i lartë për garantimin e supremacisë së Kushtetutës dhe interpretimin përfundimtar të saj. Gjykata përbëhej nga 9 anëtarë, 5 zgjidheshin nga Kuvendi dhe 4 nga Presidenti i Republikës.

Kryetari i parë i Gjykatës Kushtetuese u zgjodh gjyqtari Rustem Gjata, me votim të fshehtë nga vetë gjyqtarët. Gjyqtarja Natasha Sheshi ishte anëtarja e parë grua e gjykatës, pjesë e trupës së parë gjyqësore.

13 korrik 1992



Mbahet seanca e parë gjyqësore me dyer të hapura dhe në të njëjtën ditë Gjykata shpall edhe vendimin e parë të saj.

15 korrik 1998



Kuvendi miratoi ligjin nr.8373, "Mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili krijoi një bazë ligjore për çështjet e veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese.



28 nëntor 1998

Hyn në fuqi Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Konsolidohet roli i Gjykatës në arkitekturën institucionale. Gjyqtarët kushtetues emërohen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit. Kryetari emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit për një periudhë 3-vjeçare me të drejtë riemërimi.

10 shkurt 2000



Miratohet nga Kuvendi ligji organik i Gjykatës kushtetuese, me nr. 8577, i hartuar me ndihmën e Komisionit të Venecias. Ky ligj rregullonte çështje të tilla si, mënyrën e paraqitjes së kërkesës, shqyrtimin paraprak, procedurat e gjykimit, statusin dhe mandatin e gjyqtarit.

20 korrik 2016



Reforma në drejtësi sjell rishikime të rëndësishme në organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese, përfshirë formulën e zgjedhjes dhe emërimit të gjyqtarëve. Ridimensionohen kompetencat dhe zgjerohet ankimi individual, me qëllim forcimin e mbrojtjes së të drejtave themelore dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit kushtetues.

2018 - aktualisht



Gjykata Kushtetuese u drejtua për herë të parë nga një anëtare grua në vitin 2018, me ushtrimin nga gjyqtare Vitore Tusha, të kompetencave të Kryetares. Në periudhën 2023 - 2025 Gjykata vijoi të drejtohej nga gjyqtare Holta Zaçaj dhe aktualisht, prej dhjetorit të vitit 2025, Kryetare e Gjykatës është gjyqtarja Fiona Papajorgji.

PËRBËRJA E TRUPAVE GJYQËSORE NDËR VITE



RUSTEM GJATA
1992-1998
KRYETAR 1992-1998



MANOL KONOMI
1992-1997



FETI GJILANI
1992-1996



HILMI DAKLI
1992-2002



FRANC JAKOVA
1992-1998



VELI BUDO
1992-1998



THIMIO KONDI
1992-1994



NATASHA SHESHI
1992-1994



YLVI MYRTJA
1992-1994



RUSTEM GJATA
1992-1998
KRYETAR 1992-1998



FEJMI ABDIU
1998-2010
KRYETAR 1998-2004



GJERGJ SAULI
2001-2009
KRYETAR 2004-2007




VLADIMIR KRISTO
2007-2017
KRYETAR 2007-2010



BASHKIM DEDJA
2010-2018
KRYETAR 2010-2018



VITORE TUSHA
2008-2023
KRYETAR 2021-2023



HOLTA ZAÇAJ
2023-2025
KRYETAR 2023-2025

TRUPA E PARË E GJYKATËS KUSHTETUESE

KRYETARËT NDËR VITE

GJYQTARËT NDËR VITE



THIMIO KONDI
1992-1994

YLYI MYRTJA
1992-1994

NATASHA SHESHI
1992-1994

FETI GJILANI
1992-1996

METUSH SARAÇI
1995-1996

MANOL KONOMI
1992-1997

VELI BUDO
1992-1998

FRANC JAKOVA
1992-1998



HALIL KOPANI
1996-1998

BARDHA SELENICA
1998-2001

HAJREDIN FUGA
1998-2001

SABRI RRAPI
2000-2001

TEFTA ZAKA
2001-2002

HILMI DAKLI
1992-2000

ZIJA VUCI
1994-2004

ALFRED KARAMUÇA
1994-2006



VJOLLCA MEÇAJ
2004-2006

KRISTOFOR PEÇI
1997-2007

KUJTIM PUTO
1998-2010

SOKOL SADUSHI
1998-2011

PETRIT PLOQI
2001-2012

XHEZAIR ZAGANJORI
2002-2013

ADMIR THANZA
2009-2013

SOKOL BERBERI
2007-2016



ALTINA XHOXHAJ
2010-2018

FATMIR XHOXHA
2011-2018

BESNIK IMERAJ
2013-2018



FATOS LULO
2013-2018

GANI DIZDARI
2013-2019

PËRPARIM KALO
2020-2022

ALTIN BINAJ
2020-2023

ELSA TOSKA
2019-2024



1992-Emërimi i anëtarëve të parë



1992-Vendimi i parë

Stema ndër vite

PËRBËRJA E GJYKATËS



Sa gjyqtarë kushtetues janë?

Gjykata Kushtetuese përbëhet nga **9** anëtarë. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.



Sa i gjatë është mandati i tyre?

Gjyqtarët kushtetues qëndrojnë në detyrë për **9 vjet**, pa të drejtë riemërimi. Përbërja e Gjykatës përtërihet çdo **3 vjet** me një të tretën e saj.



Kush i për zgjedh ata?

3 emërohen nga Presidenti i Republikës
3 zgjidhen nga Kuvendi
3 zgjidhen nga Gjykata e Lartë.

Anëtarët për zgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tre vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.



Kush mund të zgjidhet gjyqtar kushtetues?

Shtetas shqiptarë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike me të paktën 15 vjet përvojë pune me veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës nuk duhet të kenë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit.



Kush e për zgjedh Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese?

Zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve



Për sa kohë qëndron në detyrë Kryetari i zgjedhur?

Për një periudhë **3-vjeçare** me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.




ANËTARËSIA AKTUALE



Dr. Fiona Papajorgji,
Kryetare e Gjykatës
Kushtetuese



Marsida Xhaferllari
Anëtare



Sonila Bejtja
Anëtare



Dr. Sandër Beci
Anëtar



Ilir Toska
Anëtar



Gent Ibrahimimi
Anëtar



Prof. Dr. Marjana Semini
Anëtare



Dr. Asim Vokshi
Anëtar



Për jetëshkrimin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese
ju lutem referojuni faqes së internetit në lidhjen:
[Përbërja – Gjykata Kushtetuese](#) ose skanoni kodin QR



Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj. Gjatë ushtrimit të funksionit të saj ajo i nënshtrohet vetëm Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese vendos për:

- a) pajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122 të Kushtetutës;
- b) pajtueshmërinë e marrëveshjeve ndërkombëtare me Kushtetutën para ratifikimit të tyre;
- c) pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore dhe vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare;
- ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;
- d) kushtetutshmërinë e partive dhe të organizatave të tjera politike, si dhe të veprimtarisë së tyre, sipas nenit 9 të Kushtetutës;
- dh) shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës dhe vërtetimin e pamundësisë së ushtrimit të funksioneve të tij;
- e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e funksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të funksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me verifikimin e zgjedhjes së tyre;
- ë) kushtetutshmërinë e referendumit dhe verifikimin e rezultateve të tij;
- f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave, përveçse kur parashikohet ndryshe në Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese, në rastin kur vihet në lëvizje për shqyrtimin e një ligji për rishikimin e Kushtetutës, të miratuar nga Kuvendi sipas nenit 177 të saj, kontrollon vetëm respektimin e procedurës së parashikuar nga Kushtetuta.

- Presidenti
- Kryeministri
- Jo më pak se një e pesta e deputetëve
- Avokati i Popullit
- Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit
- Çdo gjykatë
- Çdo komisioner i krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta
- Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë
- Organet e qeverisjes vendore
- Organet e bashkësive fetare
- Partitë politike
- Organizatat
- Individët

Ndërsa katër subjektet e para janë të pakushtëzuara, për subjektet e tjera kërkohet që të justifikojnë interesin e tyre në çështjen kushtetuese të ngritur para Gjykatës.

PROCESI KUSHTETUES

I Paraqitja e kërkesës

Kërkesa paraqitet pranë Gjykatës:



Dorazi



Me postë



Në rrugë elektronike.

II Regjistrimi i kërkesës

Drejtoria Gjyqësore kontrollon administrativisht kërkesën, verifikon plotësimin e elementeve formale dhe dokumentacionit shoqërues dhe vijon me regjistrimin e saj.

III



Kryetari i Gjykatës cakton gjyqtarin relator, nëpërmjet shortit.



Duke respektuar parimet e transparencës, objektivitetit dhe shpërndarjes së barabartë të ngarkesës.



Caktohet edhe këshilltari ligjor që do të asistojë në përgatitjen e çështjes.

IV Shqyrtimi paraprak

Kolegji i përbërë nga **3 gjyqtarë** në dhomë këshillimi verifikon nëse kërkesa mund të vijojë të shqyrtohet në themel duke shqyrtuar paraprakisht:



A hyn në juridiksionin kushtetues?



A është paraqitur nga një subjekt i legjitimuar?



A është paraqitur nga një person i autorizuar?



A janë shteruar mjetet juridike efektive?



A ka në dispozicion legjislacioni në fuqi mjete efektive?



A është respektuar afati ligjor?




A ekziston interesi i kërkuar?



A janë kërkimet e paraqitura në kërkesë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese?



A janë pretendimet haptazi të pabazuara?



V

Vendimmarrja në Kolegj

Në përfundim të shqyrtimit paraprak, Kolegji vendos njëzëri:



Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare;



Kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare publike ose mbi bazë të dokumenteve.

Në mungesë unanimiteti, çështja i kalon për shqyrtim Mbledhjes së Gjyqtarëve që vendos kalimin/moskalimin me shumicën e votave.

Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton themelin e çështjes në këtë fazë.

VI

Përgatitja e plotë e çështjes

Kur çështja kalon për shqyrtim në seancë plenare, Gjyqtari Relator merr masat për përgatitjen e plotë të çështjes dhe, nëse është e nevojshme, kërkon informacione nga subjekte të tjera.

Gjykata mund të vendosë edhe për masa të përkohshme, si pezullimi i zbatimit të aktit objekt shqyrtimi, në rast se zbatimi i tij mund të sjellë pasoja të rënda.

VII

Seanca plenare

Mund të zhvillohet publike ose mbi bazë dokumentesh, në varësi të natyrës së çështjes.

Çështjet shqyrtohen me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast të jo më pak se të dy të tretave të tyre (**6 gjyqtarë**).

Drejtohet nga Kryetari i Gjykatës



Verifikohet paraqitja dhe legjitimiteti i palëve;



Paraqiten kërkesat paraprake;



Relatori paraqet rrethanat e çështjes;



Palët parashtrojnë pretendimet dhe prapësimet e tyre;



Administrohen provat;



Palët paraqesin konkluzionet përfundimtare.



Duke respektuar parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën për t'u dëgjuar.

VIII

Dhoma e Këshillimit

Pas përfundimit të seancës plenare, Gjykata tërhiqet në dhomën e këshillimit, ku zhvillohen diskutimet dhe votimi për marrjen e vendimit.

IX

Vendimmarrja

Merret me shumicën e votave të gjyqtarëve pjesëmarrës; në mungesë të shumicës ose të ndarjes së barabartë të votave, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

Gjykata vendos:



Pranimin e kërkesës;



Rrëzimin e kërkesës.

Në çdo rast Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij.

NJË GJYKATË PËR TË GJITHË QYTETARËT: ANKIMI KUSHTETUES INDIVIDUAL

Kushtetuta e vitit 1998, parashikoi se Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte ankimet kushtetuese të individëve kryesisht në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

Ndryshimet kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, e zgjeruan ndjeshëm këtë kompetencë, duke i dhënë individit mundësinë të ankimojë çdo akt të pushtetit publik ose vendim gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.


→ Ky mekanizëm aktivizohet pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion, duke respektuar kështu parimin e subsidiaritetit.

Kompetenca e ridimensionuar përbën një hap të rëndësishëm në:

- ✓ Forcimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese si garantuese e të drejtave dhe lirive themelore të individit;
- ✓ Afrimin më tej të drejtësisë kushtetuese me qytetarin duke rritur aksesin efektiv në këtë mekanizëm mbrojtës;
- ✓ Zhvillimin e standardeve kushtetuese dhe orientimin e praktikës gjyqësore dhe administrative drejt respektimit të të drejtave themelore.

Numri i ankimeve kushtetuese individuale është rritur ndjeshëm siç tregojnë edhe statistikatat.

→ Volumi i ankimeve kushtetuese individuale reflekton pa dyshim edhe rritjen e besimit të publikut në garancitë e drejtësisë kushtetuese si dhe afirmimin në rritje të rolit të Gjykatës si garante e rendit kushtetues dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut.



Për tu njohur me manualin praktik mbi Ankimin Kushtetues Individual ju lutem referojuni faqes së internetit në lidhjen: [Manual Praktik - Ankimi Kushtetues Individual](#) ose skanoni kodin QR



VENDIMET E GJYKATËS

Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Ato hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare ose në një datë tjetër të përcaktuar në vendim.

✗ Vendimet e moskalimit





Vendimet në fazën e shqyrtimit paraprak të kërkesave merren nga Kolegji i Gjykatës, i përbërë nga tre anëtarë. Në rast dyshimi ose mungese unanimiteti, çështja i kalon për shqyrtim Mbledhjes së Gjyqtarëve, e cila vendos me shumicë votash.

✓ Vendimet përfundimtare

Vendimet përfundimtare merren nga shumica e të gjithë anëtarëve të Gjykatës, pra prej pesë gjyqtarësh.

→ Zbatimi i vendimeve të Gjykatës përbën një detyrim kushtetues, për sa kohë Kushtetuta shprehet qartësisht për forcën detyruese që kanë ato mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat.

VENDIME NDËR VITE 1992-2026



VENDIME TË SPIKATURA TË GJYKATËS KUSHTETUESE



Vendimi nr. 65



Datë 10.12.1999



Kërkues: Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Papajtueshmëria me Kushtetutën e dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, që parashikojnë dënimin me vdekje.”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, njëzëri, vendosi “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të dënimit me vdekje, në kohë paqeje, në nenet 29/1, 31, 73, 74, 75, 77, 78, 79, 109, 141, 208, 209, 219, 221, 230 dhe 334 të Kodit Penal dhe në nenet 59/2 dhe 77 të Kodit Penal Ushtarak (...) dhe shtrirjen e efekteve juridike të këtij vendimi mbi të gjitha vendimet e gjykatave të cilat përmbanin dënimin me vdekje dhe që nuk ishin ekzekutuar”.



“Thelbi i dispozitave kushtetuese është nxjerrja sa më në pah e atyre drejtimeve themelore që si orientim primar kanë respektimin e vlerës së jetës dhe të dinjitetit njerëzor. Vlera më superiore për shtetin është njeriu dhe jeta e tij. Kjo e drejtë qëndron në themel të të gjitha të drejtave dhe mohimi i saj sjell edhe eliminimin e të drejtave të tjera njerëzore. Jeta njerëzore duke u konsideruar e tillë që nga fillimi i saj bëhet një vlerë mbi të gjitha vlerat e tjera që mbrohet nga Kushtetuta. Ky është dhe qëllimi i Kushtetutës sonë, i cili del që në Preambulën e saj, si dhe në mjaft dispozita të tjera.”



Vendimi nr. 186



Datë 23.09.2002



Kërkues: Kryeministri i Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Pajtueshmëria me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i “Statutit të Romës” për Gjykatën Ndërkombëtare Penale.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, njëzëri, vendosi Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, krijuar me Traktatin e Romës, nënshkruar nga Republika e Shqipërisë në datën 18 korrik 1998, është në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.



“Gjykata Kushtetuese, duke shqyrtuar dispozitat e Statutit, duke e marrë atë në tërësi dhe duke e ballafaquar me frymën dhe përmbajtjen e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konstaton se Statuti nuk vjen në kundërshtim me Kushtetutën. Për rrjedhojë, nuk ekzistojnë pengesa kushtetuese për ratifikimin e tij. Gjykata është e bindur se ratifikimi i Statutit të GJNP-së përbën një kontribut të rëndësishëm të vendit tonë në krijimin e mundësive dhe hapësirave në luftën kundër terrorizmit në çdo formë që paraqitet ai.”



Vendimi nr. 9



Datë 23.03.2010



Kërkues: Një grup deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Prokurorëve dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit



Objekti: “Shpallja si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, njëzëri, vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të Ligjit nr. 10034, datë 22.12.2008 “Për pastërtinë e figurës së funksionarëve të lartë të administratës publike dhe të të zgjedhurve.



“Ligji për pastërtinë e figurës, i cili parashikon ndërprerjen e mandatit të Presidentit të Republikës, anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, të cilët kanë ushtruar funksione, që sipas ligjit objekt kundërshtimi janë të papajtueshme me veprimtarinë publike të zyrtarit, për shkak të qenies anëtar, drejtues apo bashkëpunëtor në strukturat politikëbërëse dhe zbatuese të dhunës së diktaturës së proletariatit apo të ish-Sigurimit të Shtetit, për periudhën 29 nëntor 1944 deri më 8 dhjetor 1990, cenon garancitë kushtetuese të mandatit të tyre dhe për rrjedhojë është në kundërshtim me parimin e kushtetutshmërisë dhe shtetit të së drejtës. Kufizimet janë vendosur me një ligj të miratuar me shumicë të thjeshtë, duke shkelur garancitë e vendosura në Kushtetutë për këto kategori. Ngritja e një institucioni si Autoriteti i Kontrollit të Figurës cenon parimin shtetit të së drejtës dhe parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve. Ky ligj kufizon edhe disa të drejta kushtetuese, si të drejtën për t'u zgjedhur, të drejtën për punë dhe të drejtën për të hyrë në administratën publike.



Vendimi nr. 15



Datë 15.04.2010



Kërkues: Partia Socialiste e Shqipërisë



Objekti: “Shqyrtimi i pajtueshmërisë me Kushtetutën e Shqipërisë të marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, njëzëri, vendosi deklarinimin si të papajtueshme me nenet 3, 4, 7 dhe 92/ë të Kushtetutës të marrëveshjes së lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare.



“Projekt-marrëveshja e nënshkruar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave përkatëse të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare” paraqet shkelje si dhe shkelje substanciale që bien në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën e Tretë Ndërkombëtare të OKB-së për të drejtën e Detit të vitit 1982. Marrëveshja e lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për delimitimin e zonave të tyre përkatëse, të shelfit kontinental dhe zonave të tjera detare që u përkasin në bazë të së drejtës ndërkombëtare”, është e papajtueshme me Kushtetutën sa i takon çështjeve lidhur me: a) mospajisjen e delegacionit shqiptar me plotfuqi të rregullt nga Presidenti i Republikës për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e marrëveshjes; b) mangësitë serioze në përmbajtjen e marrëveshjes; c) moszbatimin e parimeve bazë të së drejtës ndërkombëtare për ndarjen e hapësirave detare midis dy vendeve me qëllim arritjen e një rezultati të drejtë dhe të ndershëm; ç) mosmarrjen parasysh të ishujve si rrethana të veçanta në delimitimin e hapësirave detare.”



Vendimi nr. 5



Datë 05.02.2014



Kërkues: Një grup prej 36 deputetësh të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 30.09.2013, “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, shfuqizimin e ligjit nr.161/2013, “Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013, “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe pezullimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese.”



“Nisur nga natyra përjashtimore e kompetencës së Këshillit të Ministrave në nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit, në respekt të hierarkisë së burimeve të së drejtës, të kërkesave që burojnë nga parimi i ndarjes dhe balancimit midis pushteteve dhe vlerave mbi të cilat bazohet shteti i së drejtës, para së gjithash, kufijtë e diskrecionalitetit që ka Qeveria, në vlerësimin e situatës së jashtëzakonshme dhe të nevojës urgjente, përcaktohen dhe i nënshtrohen kërkesave kushtetuese dhe kufizimeve përkatëse. Mosrespektimi, në rastin konkret, fillimisht nga Këshilli i Ministrave, i kriterëve dhe kufizimeve kushtetuese procedurale dhe lëndore, përbën një të metë të legjitimitetit kushtetues të qeverisë për nxjerrjen e aktit normativ dhe, po ashtu, një të metë të ligjit që ka miratuar Kuvendi.”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 ‘Për nëpunësin civil’” dhe të ligjit të Kuvendit nr.161/2013 “Për miratimin e aktit normativ nr.5, datë 30.09.2013”



Vendimi nr. 19



Datë 15.04.2015



Kërkues: Një grup deputetësh, jo më pak se 1/5 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Shpallja si të papajtueshëm me Kushtetutën të ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; pezullimin e ligjit nr.115/2014 “Për ndarjen administrative të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, deri në shpalljen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese”



“Shkrirja e komunave, bashkimi i tyre, ngjitja e tyre në një njësi tjetër ose çdo formë tjetër e ndryshimit të kufijve lokalë nuk prek thelbin e vetëqeverisjes lokale si garanci kushtetuese. Vetëqeverisja nuk është një e drejtë themelore, por një parim kushtetues që përmban një garanci institucionale. Ndarja e re territoriale administrative nuk sjell cenim të barazisë së votës së shtetasve.”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës.



Vendimi nr. 7



Datë 24.02.2016



Kërkues: Një e pesta e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Kundërshtimi i vendimit nr.48/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima” dhe konstatimi i antikushtetutshmërisë së këtij vendimi; konstatimi e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetit për zotin Koço Kokëdhima; interpretimi i nenit 70 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”.



“E drejta e pakicës parlamentare për të dërguar një mocion për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit në Gjykatën Kushtetuese është e garantuar. Vlerësimi për dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese nuk është në kompetencë të Kuvendit, por vënia në lëvizje e Gjykatës kërkon një vendimarrje të këtij organi e cila është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare. Ndonëse verifikimi dhe vlerësimi i kriterëve juridiko-formale të kërkesave të kësaj natyre është një çështje që i përket Kuvendit, vlerësimi i meritës së çështjes, pra nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur ndalimin kushtetues të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një çështje që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash vendosi, pranimin pjesërisht të kërkesës; interpretimin e nenit 70/4 të Kushtetutës si vijon: Në rast se Kuvendi i Shqipërisë vihet në lëvizje me mocion të kryetarit të Kuvendit ose një të dhjetës së anëtarëve të tij, në kuptim të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, ai duhet të vendosë dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm që ka kompetencën të shqyrtojë në themel çështjen dhe të vendosë mbi papajtueshmërinë e mandatit të deputetit; konstatimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.48/2015 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosdërgimin në Gjykatën Kushtetuese të çështjes për konstatimin e papajtueshmërisë me detyrën e deputetit të zotit Koço Kokëdhima”



Vendimi nr. 1



Datë 16.01.2017



Kërkues: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, 1/5 e Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, Avokati i Popullit, Partia Republikane Shqiptare, Shoqata e Pronarëve Legjitimë “Shqiptarët”, Shoqata “Krahina Jonë”, Shoqata “Bregdeti”,



Objekti: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe KEDNJ-në i ligjit nr.133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”; pezullimi i zbatimit të ligjit nr.133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”



“Skema e re e kompensimit e miratuar për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave respekton parimin e proporcionalitetit. Kundërshtimi i vendimeve të ATP-së në Gjykatën e Apelit plotëson standardin kushtetues të së drejtës së ankimit dhe i plotëson kriteret për të pasur kontroll gjyqësor të akteve të nxjerra nga organet administrative ose kuazi gjyqësore.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës; shfuqizimin si antikushtetues të nenit 6, pika 3 dhe 5, të ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”; refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6, pika 1, shkronja “b”, si dhe të nenit 7, pika 2, shkronja “a” dhe “b” të ligjit të mësipërm; rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër.



Vendimi nr. 2



Datë 18.01.2017



Kërkues: Jo më pak se një e pesta e Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Shfuqizimi si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr.84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; pezullimi i zbatimit të ligjit nr.84/2016, datë 30.08.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”



“Sistemi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve është ngritur me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si dhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi. Është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues. Përcaktimi i kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës.



Vendimi nr. 4



Datë 15.02.2021



Kërkues: Shoqata Kombëtare “Pronësi me drejtësi”



Objekti: “Shfuqizimi i nenit 6, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe shfuqizimi i VKM-së nr. 222, datë 23.03.2016 dhe VKM-së nr. 765, datë 20.12.2017, si të papajtueshme me Kushtetutën dhe KEDNJ-në”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, njëzëri vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës; shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 7, pika 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”; shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të pikave 16/2, 16/4 dhe 18 të VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar; rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera; detyrimin e Kuvendit të Shqipërisë të plotësojë ligjin nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të tij.



“Metodologjia sipas skemës së kompensimit të miratuar në ligjin nr. 133/2015, sjell një masë më të ulët kompensimi për subjektet e shpronësuar, e cila konsiderohet si një “ndërrhyrje tjetër” në të drejtën e pronës private. Kjo masë kompensimi duhet të respektojë një nivel të caktuar, me qëllim që të mos çojë në mohimin e së drejtës së pronës private dhe të jetë në përputhje me kriteret e ndërhyrjes në kuptim të neneve 41 dhe 17 të Kushtetutës.”



Vendimi nr. 20



Datë 20.04.2021



Kërkues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit



Objekti: “Shfuqizimi i neneve 34, pika 2, shkronja “gj” dhe 38, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe shfuqizimin e nenit 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës; shfuqizimin e togfjalëshit “ edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme” të parashikuar në nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, si të papajtueshëm me Kushtetutën; rrëzimin e kërkesës për kërkimet e tjera; detyrimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të plotësojë nenin 38, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të lartpërmendur, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



“Nënshtrimi ndaj testit të poligrafit, në procesin e emërimit të drejtorit dhe të hetuesve të BKH-së, si dhe nënshtrimi ndaj testit psikologjik të personalitetit në procesin e vlerësimit të tyre, për shkak të metodës së strukturimit dhe llojit të pyetjeve që i drejtohen individit, vendosin kufizim të së drejtës së jetës private të kandidatit për këto pozicione, i cili pashmangshmërisht cenon edhe dinjitetin e tij.”



Vendimi nr. 28



Datë 30.06.2021



Kërkues: Partia “Bindja Demokratike” dhe partia “Lëvizja Demokratike Shqiptare”



Objekti: “Shfuqizimi i nenit 163 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar me nenin 21, të ligjit nr. 118/2020, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata me shumicë votash, vendosi shfuqizimin e pikës 3 të nenit 163 të Kodit Zgjedhor, si të papajtueshëm me Kushtetutën.



“Neni 163 i Kodit Zgjedhor e shndërron votën parapëlqyese në të drejtë iluzore, pasi cenon thelbin e së drejtës për të zgjedhur. Në përcaktimin e herësit nuk duhet të vendosen kufizime në një masë më të madhe se sa është e nevojshme për të arritur objektivat, në respektim të së drejtës për të zgjedhur dhe parimit të barazisë së votës. Parashikimi i herësit, lidhur me vlerën e tij numerike, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor, si kriter që ndikon në shpërndarjen e mandateve, cenon të drejtën për të zgjedhur, pasi nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit.”



Vendimi nr. 1



Datë 16.02.2022



Kërkues: Kuvendin e Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Deklarimi i shkarkimit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi shfuqizimin e vendimit nr. 55/2021, datë 09.06.2021 të Kuvendit të Shqipërisë “Për shkarkimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë për shkelje të rënda të Kushtetutës”.



“Kushtetuta nuk ka përcaktuar si shkak për përgjegjësinë kushtetuese çdo shkelje ligjore, por vetëm shkeljen e dispozitave kushtetuese, e cila, nga ana tjetër, duhet të konsiderohet e rëndë. Krahas peshës që mbart në vetvete dispozita kushtetuese e shkelur, duhet që edhe pasoja të jetë domethënëse në atë masë që të justifikohet sanksioni kushtetues i shkarkimit të Presidentit. Shkarkimi i Presidentit për shkelje të rëndë të Kushtetutës u referohet situatave të cenimit të aktit themelor në mënyrë të dukshme dhe brutale, për rrjedhojë një president që shkel rëndë Kushtetutën nuk mund të përfaqësojë unitetin e popullit dhe as të jetë garant i mbrojtjes së kushtetutshmërisë.”



Vendimi nr. 5



Datë 13.02.2024



Kërkues: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, me shumicë votash, vendosi rrëzimin e kërkesës.



Objekti: “Shfuqizimi i disa dispozitave të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe shfuqizimi i pikës 8, të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 223, datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të kompensimit të pronës dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”, të ndryshuar”, në pjesën që shton pikën 16/7, në vendimin nr. 223, datë 23.03.2016, të Këshillit të Ministrave, si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”



“Edhe pse ligji ka kufizuar të drejtën e subjekteve për të përfituar indeksim nuk ka përkeqësuar gjendjen e tyre. Për periudhën nga momenti i publikimit deri kur vendimi i kompensimit bëhet i ekzekutueshëm, subjekteve u kalon barra për plotësimin e dokumentacionit për ushtrimin e së drejtës për përfitim të kompensimit financiar. Për periudhën nga momenti që vendimi bëhet përfundimtar dhe i ekzekutueshëm dhe shteti ngarkohet me detyrimin për zbatimin e tij, subjektet përfitojnë indeksim sipas interesit bankar deri në momentin e ekzekutimit. Indeksimi si pas inflacionit përbën garancinë minimale dhe, nga ana tjetër, shteti nuk zhvishet nga detyrimi që të përgjigjet për vonesat e mëparshme të shkaktuara ndaj subjekteve. Rezultati i testimit të zbatimit të të gjitha varianteve të formulave të parashikuara nga ligji sipas kufijve të formulës së parashikuar në çështjen Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, provoi se përmbushen detyrimet e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, ndaj nuk ka cenim të së drejtës së pronës.”



Vendimi nr. 44



Datë 29.07.2025



Kërkues: Oneida Ymeraj



Objekti: “Shfuqizimi i vendimeve të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si dhe të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.”



“Vendimi për masën e sekuestrimit duhet të përcaktojë, së paku, garancitë procedurale për minimizimin e ndërhyrjes, veçanërisht në drejtim të: (a) kufizimit të fushës së kërkimit; (b) kufizimit të kohës së ruajtjes dhe të rrethit të ekspozimit të të dhënave; (c) si dhe dokumentimit të detajuar të të gjitha veprimeve të kryera. Në rastet e urgjencës, si përjashtim, pajisja elektronike mund të sekuestrohet me iniciativë të OPGJ-së, pa vendim paraprak të gjykatës, por masa duhet t’i nënshtrohet kontrollit automatik të prokurorit dhe kontrollit gjyqësor ex post (mbi ankimin e individit, në aspektin e urgjencës dhe të nevojës) me kontradiktoritet dhe me pjesëmarrjen e palëve.”



Vendimi nr. 60



Datë 16.10.2025



Kërkues: Presidenti i Republikës së Shqipërisë



Objekti: “Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.”



“Edhe pse mandati i gjyqtarit kushtetues ka kuptimin e një mandati të dhënë, parimi i pavarësisë nënkupton gjithashtu se, gjyqtari në momentin e emërimit duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë. Gjykata thekson se parim i përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese mbizotëron mbi atë të patundshmërisë në detyrë të gjyqtarit.”

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata, njëzëri, vendosi pranimin e pjesshëm të kërkesës; konstatimin e cenimit të fshehtësisë së korrespondencës, si dhe të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, për pjesën që ato nuk lidhen me objektin e hetimit penal; asgjësimin e kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale të nxjerra nga telefoni celular i kërkuës që nuk lidhen me objektin e hetimit penal, si dhe vijimin e mbajtjes në sekuestro të kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale që lidhen me objektin e hetimit penal, duke ia nënshtroar kontrollit gjyqësor; urdhërimin e zbatimit të garancive procedurale të parashikuara në arsyetimin e këtij vendimi në vijimin e mbajtjes në sekuestro të telefonit celular, si send që mbart korrespondencë dhe të dhëna personale; Ngarkimin e Prokurorisë së Posaçme për ekzekutimin e vendimit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij, duke respektuar garancitë procedurale.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata njëzëri dhe me shumicë votash vendosi se kompetenca për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues i përket Gjykatës Kushtetuese dhe vetëm pas kësaj organi i emërtesës ushtron kompetencën e tij të emërimit/zgjedhjes të gjyqtarit kushtetues. Interpretimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, si vijon.” Qëllimi i dispozitës kushtetuese është garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, parim i përcaktuar në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës. Për këtë arsye, neni 179, pika 3, i Kushtetutës ka përcaktuar shkurtimin me më pak se 9 vjet të mandateve të dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, njëri deri në vitin 2025 dhe tjetri deri në vitin 2028. Për sa i përket “kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit” të gjyqtarëve të tjerë, kjo dispozitë kushtetuese i referohet nenit 86, pika 4, të Ligjit Organik të Gjykatës, i cili ka përcaktuar skemën kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar përtëritjen e parë me një të tretën në vitin 2025, përtëritjen e dytë me një të tretën në vitin 2028 dhe përtëritjen e tretë me një të tretën në vitin 2031. Fillimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përgjatë këtij regjimi tranzitor përkon me datën e deklaruar nga Gjykata Kushtetuese të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson.

ADMINISTRATA

Trupa gjyqësore mbështetet në veprimtarinë e saj nga administrata e Gjykatës Kushtetuese e përbërë nga këshilltarët ligjorë, stafi i Kabinetit të Kryetarit, nëpunësit civilë dhe punonjësit mbështetës.



Struktura organizative ka gjithsej **88** punonjës.



BASHKËPUNIMI DHE PERSPEKTIVA NDËRKOMBËTARE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë i kushton rëndësi të veçantë dimensionit ndërkombëtar të veprimtarisë së saj, duke e konsideruar atë një komponent të rëndësishëm për zhvillimin e jurisprudence dhe forcimin e rolit të saj institucional.

Në këtë kuadër, dialogu gjyqësor me gjykatat homologe dhe juridiksionet ndërkombëtare përbën një mekanizëm thelbësor për shkëmbimin e praktikave dhe qasjeve në interpretimin e normave kushtetuese, me synim rritjen e koherencës së vendimmarrjes dhe konsolidimin e qëndrueshmërisë së jurisprudence, veçanërisht në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore.

Ky dialog gjen shprehje konkrete përmes angazhimit aktiv të Gjykatës në forume dhe rrjete ndërkombëtare, të cilat krijojnë hapësira të strukturuar për diskutim dhe reflektim mbi zhvillimet bashkëkohore të drejtësisë kushtetuese. Pjesëmarrja në këto platforma mundëson jo vetëm shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, por edhe trajtimin e çështjeve me interes të përbashkët, përfshirë sfidat që burojnë nga evoluimi i shoqërisë dhe i teknologjisë. Në këtë kontekst, ky ndërveprim i vazhdueshëm ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë dhe koherencës së vendimmarrjes gjyqësore, si dhe në përafrimin e jurisprudence kushtetuese me zhvillimet më të fundit në nivel evropian dhe jo vetëm.

Njëkohësisht, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë vijon të zhvillojë marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me institucione homologe dhe partnerë ndërkombëtarë, përmes marrëveshjeve dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërinstitucional, të cilat konkretizohen në shkëmbimin e vizitave studimore, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, si dhe në ndarjen e përvojave mbi çështje të jurisprudence dhe administrimit gjyqësor. Ato synojnë thellimin e ekspertizës, mbështetjen e proceseve të modernizimit dhe forcimin e kapaciteteve institucionale, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e funksionimit të Gjykatës dhe në konsolidimin e rolit të saj në rendin juridik shqiptar.

Po kështu, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe projektet e asistencës së huaj brenda vendit zë një vend të rëndësishëm në veprimtarinë institucionale të Gjykatës Kushtetuese. Ai mbetet thelbësor për realizimin efektiv të objektivave strategjike dhe prioritetive të saj institucionale.

Të ndërlidhura ngushtësisht me njëra – tjetrën, këto shtylla bashkëpunimi forcojnë më tej pozicionimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në hapësirën juridike evropiane, duke kontribuar në përmbushjen e standardeve dhe avancimin e procesit të anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.



ANËTARËSIA NË FORUME DHE ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË

2000

Anëtare me të drejta të plota e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane

2002

Anëtare me të drejta të plota e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone

2011

Anëtare me të drejta të plota e Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese

2016

Anëtare e Rrjetit të Gjykatave Supreme Europiane – forum i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

2023

Anëtare e Forumit të Gjykatave Kushtetuese të Ballkanit

2024

Zgjidhet gjykata kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane për periudhën 2024–2027 si dhe organizatore e Kongresit të ardhshëm të XX-të në Shqipëri.

Në cilësinë e saj si Gjykata kryesuese e CECC, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë është edhe anëtare e Byrosë Drejtuese të Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese.

2025

Zgjidhet anëtare e Byrosë Drejtuese të Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone për periudhën 2025 – 2028



DATA TË RËNDËSISHME PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR

2009

16 korrik

Marrëveshja për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë me Gjykatën Kushtetuese të Italisë.

2013

9-12 qershor

Marrëveshja për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë me Gjykatën Kushtetuese të Turqisë.

2021

29 shtator

Marrëveshja e re me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

2024

5 mars

Marrëveshja e Bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Spanjës.

2024

25 shtator

Rivitalizohet Marrëveshja e Bashkëpunimit me Gjykatën Kushtetuese të Italisë.

2025

6-8 maj

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë zgjidhet për herë të parë nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone si anëtare e Byrosë së saj.

2011

18-20 prill

Marrëveshja për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë me Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

2021

14 prill

Memorandumi i Mirëkuptimit me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

2024

19 shkurt

Marrëveshja Kuadër për Bashkëpunimin Institucional me Dhomën e Avokatisë të Shqipërisë.

2024

22-24 maj

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë zgjidhet si gjykata kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane 2024 – 2027.

2025

28 shkurt

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, si kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC), zhvilloi në Tiranë Takimin Përgatitor të Rrethit të Presidentëve, një nga organet drejtuese dhe vendimmarrëse të Konferencës.

KONTRIBUTI NË KULTURËN KUSHTETUESE

Gjykata Kushtetuese ka luajtur një rol të rëndësishëm në konsolidimin e kulturës kushtetuese në Shqipëri, jo vetëm përmes ushtrimit të funksionit të saj gjyqësor, por edhe nëpërmjet sistematizimit, publikimit dhe promovimit të jurisprudencës kushtetuese. Përmes botimeve profesionale, përmbledhjeve tematike dhe indekseve sistematike, Gjykata ka kontribuar në rritjen e transparencës, aksesueshmërisë dhe kuptueshmërisë së vendimmarrjes kushtetuese për profesionistët e së drejtës, institucionet publike, akademinë dhe publikun e gjerë.

Që prej vitit 1992, publikimi i përmbledhjeve vjetore të vendimeve ka krijuar një bazë të konsoliduar dokumentare të jurisprudencës kushtetuese, duke mundësuar evidentimin e evoluimit të standardeve kushtetuese ndër vite. Këto botime janë shoqëruar me indekse sistematike dhe alfabetike, të cilat kanë lehtësuar kërkimin dhe referimin profesional në praktikën kushtetuese.

Në vijim, Gjykata ka zgjeruar kontributin e saj edhe përmes botimeve tematike, të përqendruara në çështje me rëndësi të veçantë kushtetuese dhe shoqërore. Këto përmbledhje kanë shërbyer si instrumente orientuese për interpretimin e Kushtetutës dhe standardeve të shtetit të së drejtës, duke ndihmuar në unifikimin e praktikës juridike dhe forcimin e sigurisë juridike.

Botime të posaçme, si Buletini “10-vjet Gjykatë Kushtetuese, 1992–2002” apo Buletini “5-vjet Kushtetutë, 1998–2003”, përfaqësojnë një reflektim institucional mbi zhvillimin e drejtësisë kushtetuese në Shqipëri, sfidat e tranzicionit demokratik dhe ndikimin e jurisprudencës kushtetuese në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore.

Nëpërmjet këtyre iniciativave, Gjykata Kushtetuese ka kontribuar në krijimin e një kulture juridike më të konsoliduar, në forcimin e besimit të publikut tek drejtësia kushtetuese dhe në promovimin e vlerave të Kushtetutës si themel i shtetit demokratik dhe sundimit të ligjit.

1992 - aktualisht

Përmbledhjet Vjetore të
Vendimeve
Indeksi Sistematik dhe
Alfabetik



2001

Procesi zgjedhor



2003

Buletin i Posaçëm
“10-vjet Gjykatë
Kushtetuese, 1992–2002”




2004

Buletin i Posaçëm
“5-vjet Kushtetutë,
1998–2003”



2006

“Kthimi dhe kompensimi
i pronave subjekteve të
shpronësuara në praktikën
e Gjykatës Kushtetuese
Shqiptare”




2007

Vendime me objekt
interpretimi të Kushtetutës
së Republikës së
Shqipërisë Gjykatës
Kushtetuese shqiptare



2012

Vendime të Gjykatës
Kushtetuese - Parimi i
“Ndarjes dhe balancimit të
pushteteve” 1998-2011



2012

20 vjet Gjykatë Kushtetuese
– Konferencë Ndërkombëtare
“Ndarja dhe balancimi i
pushteteve
– Roli i kontrollit kushtetues”




2023/2024/2025

Raporte Vjetore



2024

Udhërrëfyes “Për
jurisprudencën e Gjykatës
Kushtetuese lidhur me
Ankimin Kushtetues
Individual 1998-2023”



2016

Vendime të Gjykatës
Kushtetuese me objekt
garantimin e së drejtës së
pronës 1993-2015



2017

Konferencë Ndërkombëtare
“Europeanizimi i së
Drejtës Kushtetuese dhe
Konstitucionalizimi i së
drejtës europiane, sfidat e së
ardhmes”



2024 /aktualisht

Buletini elektronik 2
muaj i vendimmarrjes së
Gjykatës Kushtetuese



2024

Manuali për ankimin
kushtetues individual



2022

Vendime të përzgjedhura,
30 vite Gjykatë
Kushtetuese 1992-2022



2005/2009/2011

“Histori
Kompetenca
Organizim”



2025

Udhërrëfyes “Për
jurisprudencën e Gjykatës
Kushtetuese 1992-2024
lidhur me parimet, të
drejtat dhe liritë themelore
të njeriut (të drejtat
materiale)”



2026

Udhëzues praktik
për qytetarët



S tema e Gjykatës përmban simbolin e shqiponjës dykrenore mbi të cilën është vendosur përkrenarja e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit, Skënderbeut duke simbolizuar identitetin kombëtar shoqëruar me një ngjyrë të artë që simbolizon solemnitetin institucional. Në zemër të shqiponjës ndodhet një medalje rreth e qark së cilës është shkruar Republika e Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese dhe nën të rrethohet nga gjethe të dushkut me ngjyrë të gjelbër që simbolizojnë qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e rendit kushtetues. Në qendër të medaljes ngrihet mbi një sfond blu peshorja e drejtësisë duke përçuar objektivitet dhe paanësi. Në pjesën mbështetëse të peshores gdhendet viti i themelimit të Gjykatës Kushtetuese, 1992.



G jyqtari Kushtetues mban një togë solemne e karakterizuar nga një pëlhurë e zezë me pjesë kadife që transmeton dinjitet, autoritet e solemnitet e shoqëruar me shirita të kuq në kraharor dhe mëngë të cilat theksojnë simbolikën kombëtare. Në krahun e majtë, në sup, bien 3 kordonë të lëshuar, 2 me ngjyrë të kuqe dhe 1 me ngjyrë floriri të verdhë të cilët përforcojnë karakterin ceremonial dhe solemn të veshjes. Në krahun e majtë, në kraharorin e Gjyqtarit Kushtetues, vendoset emblema e Gjykatës, si elementi më i rëndësishëm identifikues që shënon identitetin përfaqësues të autoritetit të institucionit.



S elia e Gjykatës Kushtetuese ndodhet në zemër të Tiranës, në një nga krahët e një prej godinave më përfaqësuese të bulevardit “Dëshmorët e Kombit”, ku janë rreshtuar institucionet më të rëndësishme shtetërore si Kryesia e Kuvendit, Kryeministria, Presidenca si dhe institucione të tjera qendrore të administratës shtetërore.

Vendndodhja e Gjykatës në aksin kryesor institucional të kryeqytetit, simbolizon dhe thekson rolin e saj si organi më i lartë për garantimin e Kushtetutës, ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Godina u projektua në vitin 1953 dhe përbën një shembull të spikatur të arkitekturës neoklasike në Tiranë, ajo mishëron stilin monumental karakteristik të ndërtesave zyrtare të ndikuara nga estetika e periudhës sovjetike, duke ndërthurur elemente klasike me funksionalitetin modern.

Pas ndryshimeve demokratike të vitit 1991, godina mori një funksion të ri institucional. Në këtë hapësirë u vendosën institucione të rëndësishme shtetërore, si Kryesia e Kuvendit, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, etj.



Gjykata Kushtetuese synon të jetë e hapur dhe transparente për qytetarët, duke promovuar aksesin dhe besimin e publikut përmes:

Ditëve të Hapura: rrisim ndërgjegjësimin publik mbi rolin dhe funksionet e Gjykatës Kushtetuese, duke synuar forcimin e kulturës kushtetuese.

Pjesëmarrjes së publikut në Seanca Plenare Publike: garantojmë transparencë të procesit kushtetues.

Transmetim direkt i seancave publike: zgjerojmë aksesin, duke siguruar informim të menjëhershëm dhe të barabartë për publikun.

Prezencë në rrjet:

→ Faqja e internetit: www.gjykatakushtetuese.gov.al

→ Rrjete sociale:    

Publikime

→ Buletine Periodike

→ Udhërrëfyes

→ Përmbledhje vjetore dhe tematike e vendimeve

Mënyra të ndryshme komunikimi me publikun

→ Komunikata për shtyp

→ Konferenca për mediat

→ Kërkesa për informim

→ Raporti vjetor

→ Videot informuese

Për të vizituar faqen
e internetit, ju lutemi skanoni kodin QR



